



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
SENATI AKADEMIK

Nr. 223/3 Prot.

Tiranë, më 26.07.2021

VENDIM

Nr. 28, datë 22.07.2021

“Për miratimin e programit të Grantit për prezantimin e një punimi/kërkimi në konferenca ndërkombëtare”

Bazuar në ligjin Nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, neni 3, germa “c”, neni 95, neni 108, neni 110, germa “c” dhe neni 113; Statutin e Universitetit të Tiranës, neni 31, germa “c”, neni 114 dhe neni 120, Senati Akademik i Universitetit të Tiranës, në mbledhjen e datës 22.07.2021,

VENDOSI:

1. Miratimin e programit të Grantit për prezantimin e një punimi/kërkimi në konferenca ndërkombëtare.
2. Vendimi t’i përcillet Bordit të Administrimit të Universitetit të Tiranës.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Prof. Dr. Artan Hoxha



UDHËZUES

Për Programin e Grantit për prezantimin e një punimi/kërkimi në konferenca ndërkombëtare

A Qëllimi i Programit të Grantit për prezantimin e një punimi/kërkimi në konferenca ndërkombëtare

Në përputhje me objektivin 4 të Planit të Kërkimit Shkencor të Universitetit të Tiranës për vitin 2018-2022 ky Grant i financuar nga buxheti i Universitetit të Tiranës synon të mbështesë mbulimin e shpenzimeve të transportit, dietat dhe të tarifës për prezantimin e punimeve kërkimore në konferenca akademike ndërkombëtare brenda vendeve të Bashkimit Evropian (BE-së)

B Kriteret e Pranimit

Granti për prezantimin në konferenca ndërkombëtare do t'i jepen vetëm personelit akademik me kohë të plotë që prezanton kërkimin në një konferencë ndërkombëtare në vendet e BE-së.

Brenda 2 viteve kalendarike, çdo personel akademik me kohë të plotë, përfiton vetëm njëherë nga ky grant.

Kërkimi i propozuar për t'u prezantuar duhet të jetë në përputhje me Strategjinë Kombëtare për Kërkimin dhe Inovacionin, Planin e Kërkimit Shkencor të Universitetit të Tiranës 2018-2022, si dhe Fushat Kërkimore të Njësisë Bazë ku kandidati për këtë grant është personel akademik me kohë të plotë.

Personeli akademik me kohë të plotë që merr pjesë në konferenca për qëllime të tjera (p.sh., si dëgjues/anëtar/moderator i një sesioni) apo nëse ai/ajo kryen një prezantim të një punimi në një departament ose fakultet në një universitet jo në kuadër të një konference ndërkombëtare nuk do të financohet nga ky grant.

Financimi për prezantimin në një konferencë ndërkombëtare do të jepen në mënyrë prapavepruese. Në rastin e bashkautorësisë financimi do t'i ofrohet vetëm një autori i cili do të prezantoj kërkimin në konferencë.

C Dokumentet mbështetëse

Të gjitha aplikimet për këtë grant duhet të bëhen pranë Zv.Dekanit/ Drejtorit të Institutit që mbulon kërkimin shkencor në Njësitë Kryesore, jo më vonë se dy muaj përpara pjesëmarrjes në konferencë dhe duhet të shoqërohen nga dokumentet e mëposhtëm:

1. Formularin e Aplikimit për Grantin për prezantimin e një punimi/kërkimi në konferenca ndërkombëtare (Aneksi 1 i këtij udhëzimi);
2. Një kopje e abstraktit të zgjeruar (1 000-2 500 fjalë);
3. Një dokument që përshkruan konferencën dhe motivimin e personelit akademik me kohë të plotë për të marrë pjesë në këtë konferencë, si edhe arsyetimin që kërkimi që do të prezantohet është në përputhje me Strategjinë Kombëtare për Kërkimin dhe Inovacionin, Planin e Kërkimit Shkencor të Universitetit të Tiranës 2018-2022, si dhe Fushat Kërkimore të Njësisë Bazë (1 000-2 500 fjalë);
4. Një letër pranimi për prezantimin në konferencë ose botimin në revistë;

5. Një deklaratë nga vetë kandidati/kërkuesi që nuk do të marrë mbështetje financiare nga konferenca.

D. Procedura e Miratimit të kërkesës për mbulimin e pjesëmarrjes së konferenca ndërkombëtare

Dekanati miraton ose jo kërkesën e kandidatit për Grantin për prezantimin e një punimi/kërkimi në konferenca ndërkombëtare brenda vendeve të BE-së, duke pasur në konsideratë fushat parësore të kërkimit shkencor dhe fondin e parashikuar në buxhet.

Miratimi bëhet sipas procedurës së formalizuar dhe standartizuar të njësisë kryesore.

Pas miratimit të kërkesës nga Dekanati procedura kalon për ekzekutim Administratorit të Njesisë Kryesore për mbulimin e shpenzimeve përkatëse për pjesëmarrje në konferencën ndërkombëtare, me dokumentat justifikuese, pas zhvillimit të aktivitetit.

Lista e personelit akademik, i cili mbështetet financiarisht vendoset ne faqen eletronike zyrtare të njësisë kryesore.

E Kostot e praneshme për t'u rimbursuar dhe Dokumentacioni Justifikues

Ky grant do të mbulojë financimin për shpenzime transporti dhe dietat sipas procedurës së legjislacionit në fuqi. Për tarifën e regjistrimit/pjesëmarrjes në konferencë sipas dokumentacionit shoqërues. Çdo staf akademik me kohë të plotë mund të përfitojë nga ky grant 1 herë brenda dy viteve financiare, vetëm në një vendndodhje gjeografike.

Për qëllimet e vlerësimit financiar dhe / ose auditimi, përfituesi i grantit mbas pjesëmarrjes në konferencë duhet të arsyetojnë dhe të vërtetojnë elementet vijues:

- ✓ Udhëtimi të ketë ndodhur (dokumentacioni që vërteton shpenzimet e udhëtimit)
- ✓ Udhëtimi të jetë i lidhur me konferencën specifike për të cilën është kërkuar granti

Dokumentet e mëposhtme mbështetëse duhet të dorëzohen pranë Administratorit të Njesisë Kryesore:

- ✓ Një Raport Udhëtimi (Aneksi 2 i këtij Udhëzuesi);
- ✓ Dokumentacioni mbështetës do të duhet t'i bashkëlidhet raportit të udhëtimit në mënyrë që të justifikojë që udhëtimi dhe konferenca kanë ndodhur vërtetë (p.sh. biletat e udhëtimit, Boarding passes të nisjes/kthimit dhe të destinacionit, siguracioni i shëndetit në udhëtim, vula të pasaportës me datën e nisjes dhe të kthimit, një kopje të faturës së tarifës së konferencës së paguar, agjenda dhe programi i konferencës, proceedings, libri i abstrakteve).

Rimbursimi i Grantit nuk do të përfitohet nëse nuk paraqiten dokumentet justifikuese të sipërpërmendura që vërtetojnë pjesëmarrjen në konferencë.

ANEKSI I
FORMULARI I APLIKIMIT PËR GRANTIN PËR PREZANTIMIN NË KONFERENCA NDËRKOMBËTARE
BREDA VENDEVE TË BE-SË ¹

INFORMACIONI PËR KANDIDATIN

Emër Mbiemër		
Adresa e Email-it		
Departamenti/Fakulteti/ Instituti		
Vendndodhja e Konferencës		
Emri i Konferencës		
Datat e konferencës	Nga data	Në datën
Ëëbsite i Konferencës		
Grada/Titulli		

Arsyeja e pjesëmarrjes në Konferencë

<input type="checkbox"/>	<p>Prezantim oral formal i gjetjeve të kërkimit shkencor (vendosni x në kutizën përmbri) Ju lutemi bashkëlidhni dokumentacionin e kërkuar në vijim:</p> <ul style="list-style-type: none">✓ Një kopje të abstraktit të zgjeruar (1 000-2 500 fjalë)✓ Një dokument që përshkruan konferencën dhe motivimin tuaj për të marrë pjesë në këtë konferencë ku të paraqitet arsyetimi që kërkimi që do të prezantohet është në përputhje me Strategjinë Kombëtare për Kërkimin dhe Inovacionin, Planin e Kërkimit Shkencor të Universitetit të Tiranës 2018-2022, si dhe Fushat Kërkimore të Njësisë Bazë përkatëse të kandidatit për këtë grant (1 000-2 500 fjalë).✓ Një letër pranimit për prezantimin në konferencë✓ Një deklaratë nga vetë kandidati/kërkuesi që nuk po merr asnjë të ardhur nga pjesëmarrja në këtë konferencë.
--------------------------	--

KËRKESA PËR FINANCIM

Shpenzimi transporti (vlera në lekë) (ALL _____) (me fjalë.....)
Shpenzime tarife Konference (vlera në lekë) (ALL _____) (me fjalë.....)

SHUMA TOTALE E KËRKUAR:	ALL
-------------------------	------------

NËNSHKRIMI I KANDIDATIT: _____

NËNSHKRIMI I ZV. DEKANIT(DREJTORIT TE INSTITUTIT) PËR KËRKIMIN SHKENCOR _____

DATA: _____

DATA: _____

¹ Shënim: Çdo anëtar i stafit akademik më kohë të plotë në Universitetin e Tiranës ka të drejtë të përfitojë një grant çdo dy vite financiare. Ju lutemi referojuni Udhëzuesit për Grantin për prezantimin në Konferenca Ndërkombëtare brenda vendeve të BE-së. Kërkesa për financim duhet të dorëzohet pranë Zv. Dekanit përgjegjës për kërkimin shkencor një Njësitë Kryesore të paktën 2 muaj përpara pjesëmarrjes në Konferencë. Ky aplikim do të vlerësohet nëse janë plotësuar të gjitha sesionet si dhe janë bashkëlidhur dokumentet përkatëse.

ANEKSI 2
FORMULARI I UDHËTIMIT PËR PREZANTIMIN NË KONFERENCA NDËRKOMBËTARE BRENDA
VENDEVE TË BE-SË

Numri i Referencës.....

Numri i referencës do të plotësohet nga Zyra e Financës në momentin e dorëzimit të këtij formulari

TË DHËNA PERSONALE

Emër Mbiemër	
Adresa e Email-it	
Departamenti/Fakulteti/ Instituti	
Pozicioni i punës	

Përshkrimi i aktiviteteve të realizuara gjatë pjesëmarrjes së konferencës dhe prezantim i shkurtër i konferencës

DATAT E KONFERENCËS) Nga Data:..... Në Datën

Përshkrimi i shkurtër i konferencës dhe i aktiviteteve të realizuara:

.....
.....
.....

Detaje të udhëtimit

Periudha	Data e nisjes	Data e kthimit
Vendi i Nisjes	DEPARTAMENTI/FAKULTETI/INSTITUTI.....	
Vendi i Mbërritjes/ Vendndodhja e Konferencës	INSTITUCIONI ORGANIZUES..... SHTETI..... QYTETI	

NËNSHKRIMI I PJESEMARRËSIT

Me anë të këtij formulari deklaroj se kam qenë pjesëmarrës në konferencën dhe aktivitetet e realizuara

Data: Nënshkrimi:.